
INTERNATIONAL TRADE AND PROTECTION POLICIES IN FRONT FREE TRADE

Feim Brava

University for Business and Technology (UBT), Department of Management, Business and Economics,
feim.brava@ubt-uni.net

Ljubomir Kekenovski

Faculty of Economics, UKIM, Skopje, N. Macedonia

Abstract: Trade was the main means of not only communication between people, but also the exchange of goods and goods between these people, all through the mechanisms known as the market. With the creation of large communities and later with the emergence of states, there was a need for exchange of products and services between states. At this moment, there was a need to create new mechanisms for trade to take the size of international exchanges. The creation of these new mechanisms made the international economy today to be considered as one of the main components of the world economy. International trade enables and encourages international labor sharing, while foreign trade development depends on the international division of labor. Separation of work and specialization in the production of certain products in the international aspect condition the countries' mutual economic interdependence and interdependence. For trade to reach the international dimension, it has been a gradual development over the centuries which led to an economic, social, political and cultural development reaching a high level in recent decades as a result of the process of industrialization, advanced transport, globalization and the birth of multinational corporations .

Keywords: ITR,GATT,WTO,EU,barriers

TREGTIA NDËRKOMBËTARE DHE POLITIKAT PROTEKSIONISTE PËRBALLË TREGTISË SË LIRË

Feim Brava

University for Business and Technology (UBT), Department of Management, Business and Economics,
feim.brava@ubt-uni.net

Ljubomir Kekenovski

Faculty of Economics, UKIM, Skopje, N. Macedonia

Abstrakti: Tregtia njihet si mjeti kryesor përmes së cilës filluan jo vetëm komunikimet në mes njerëzve , por edhe shkëmbimi i të mirave dhe mallrave ndërmjet këtyre njerëzve e ku të gjitha realizoheshin përmes mekanizmave të njohura si tregje.

Me krijimin e bashkësive të mëdha dhe më vonë me lindjen e shteteve, u paraqit nevoja e këmbimit të produkteve dhe shërbimeve në mes të shteteve . Ne kete moment,lindi nevoja për krijimin e mekanizmave të reja që tregtia të marrë përmasat e shkëmbimeve ndërkombëtare. Krijimi i këtyre mekanizmave të reja ,bëri që sot ekonomia ndërkombëtare të konsiderohet si një nga komponentët kryesorë të ekonomisë botërore. Tregtia ndërkombëtare mundëson dhe nxit ndarjen ndërkombëtare të punës ,ndërsa zhvillimi i tregtisë së jashtme varet nga ndarja ndërkombëtare e punës. Ndarja e punës dhe specializimi në prodhimin e produkteve të caktuara në aspektin ndërkombëtar ,kushtëzon lidhshmërinë dhe ndërvaresinë e ndërsjellë ekonomike të vendeve. Pra, që tregtia të arrijë përmasat ndërkombëtare është dashur një zhvillim gradual përgjatë shekujve çka solli një zhvillim ekonomik, social, politik dhe kulturor duke arritur një nivel të lartë dekadat e fundit si rezultat i procesit të industrializimit, transportit të avancuar, globalizimit dhe lindjen e korporatave multinacionale.

Fjalet kyqe: TN,GATT,OBT,UE,barrierat,proteksionizmi

PROTEKSIONIZMI PËRBALLË TREGTISË SË LIRË

Politikat tregtare variojnë ndërmjet dy ekstremeve, nga mbrojtja prej tregtisëpër industrinë vendase (politika proteksioniste) deri tek tregtia e lire (politika e tregtisë së lirë). Mbështetja për tregtinë e lirë qëndron në besimin se, tregtia e pakufizuar ndërmjet gjithë vendeve do të rezultojë në një përdorim sa më eficient të burimeve botërore dhe me një standard jetese më të lartë për të gjithë.

Gjithësesi, shumë vende vendosin të heqin dorë nga këto të ardhura në favor të politikave tregtare mbrojtëse. Gjatë gjithë historisë ka pasur zhvendosje të shpeshta ndërmjet këtyre dy politikave. Proteksionizmi i referohet politikave të tregut dhe mjeteve që pengojnë tregtinë e lirë ndërmjet vendeve. Midis mjeteve mbrojtëse janë tarifatat (taksat për importet) kuotat, licensat, ndalesat, importet dhe subvencionet qeveritare për industrinë që nuk mund të konkurojnë ndryshe në tregjet botërore. Politikat proteksioniste në cdo rast paraqiten si politika që synojnë mbrojtjen e mirëqenies ekonomike kombëtare.

Ka edhe pengesa të tjera në tregti që shtrembërojnë cmimet dhe pengojnë/veshtirësojnë tregtinë ndërkombëtare.

- **Embargo** është një ndalim në eksportet e produkteve të tjera në vendet e tjera, zakonisht si masë ndëshkuese.
- **Statusi i vendit më të favorizuar** i referohet preferencave diskriminuese në tregti i dhene për një vend ndaj një tjetri.
- **Dampingu** i referohet praktikave të një vendi për të shitur tepricat e produkteve në tregjet e huaja me qmime nën kosto.
- **Marrëveshjet tregtare dypalëshe** janë rregullime speciale të tregtisë të bëra ndërmjet dy vendeve, të cilat nuk janë të përdorshëm për vendet e tjera.¹⁷¹

ARGUMENTET PRO DHE KUNDËR TREGTISË SË LIRË

Argumentet në favor të tregtisë së lirë:

1. Prodhuesit dhe konsumatorët i alokojnë burimet në mënyren më efikiente kur qeveria nuk shtrembëron tregjet nëpërmjet politikës tregtare:
 - Mirëqenia ekonomike e një vendi të vogël është e lartë në kushtet e tregtisë lirë.
 - Kur tregtia kufizohet, konsumatorët paguajnë qmime më të larta.
 - Kur tregtia kufizohet, cmimet e shtrembëruara shkaktojnë mbiproduhim ose nga kompanite ekzistuese ose nga kompanite e reja që hyjnë në sektor.
2. Lejon specializimin e vendeve mbi bazën e avantazheve krahasuese.
3. Sidoqoftë, për shkak se tarifatat janë tashmë të ulëta për shumicën e vendeve, përfitimi në kalimin e tregtisë së lirë është i vogël për shumicën e vendeve.
4. Zhvillimi i konkurrencës dhe krijimi i motiveve për inovacion.
5. Argumenti politik në favor të tregtisë së lirë:

Argumentet kundër tregtisë së lirë:

1. Për një vend të madh, një tarifë ose kuotë (mbrojtja më anë të tarifave), ulë cmimin e importeve në tregjet botërore dhe në këtë mënyrë përmirëson kushtet e tregtisë. Ky përfitim mund të tejkalojë kostot e lidhura me shtrembërimin e prodhimit dhe konsumit. Në fakt një tarifë deri në një masë të caktuar do të shoqërohet me rritjen e mirëqenies kombëtare të një vendi të madh.
2. Një tarifë që kufizon tregtinë e lirë, bënë të mundur të rris investimet vendase.
3. Ky argument kundër tregtisë së lirë ka të bëjë me atë që prania e mangësive të brendshme të tregjeve mund të rezultojë në një situatë ku tregtia e lirë mund të jetë një politikë jo optimale.
4. Aplikimi i tarifave mbi importet, ka një justifikim të mirë kur kjo bëhet për të mbrojtur produktet që vendi ka avantazhe të krahasuara (mbrojtja e industrive foshnjore).
5. Rolin e qeverisë për të adresuar mangësitë e tregut kur nuk ekzistojnë politika të tjera.¹⁷²

INSTITUCIONI I TREGTISË SË LIRË DHE ORGANIZATA BOTËRORE E TREGTISË (OBT)

OBT-ja filloi të funksionojë për t'u përballur me sfidat e tregtisë botërore me 1 janar të vitit 1995. Ky sistem tregtar që u përfaqësua që në vitin 1948 me emrin ose me anë të **marrëveshjes së përgjithshme mbi tarifatat dhe tregtinë (GATT)**. Për vite më rradhë ky kuadër masash politike dhe ekonomike u zhvillua nëpërmjet raundeve të bisedimeve. Krijimi i OBT-së shënon reformen më të madhe në tregtinë ndërkombëtare që pas luftës së dytë botërore. Pra ky krijim shndërron në realitet një përpjekje të deshtuar për krijimin e një Organizate Ndërkombëtare Tregtare në vitin 1948. Pra deri në vitin 1994 sistemi tregtar vepronte në kuadrin e GATT-it gjë që ndihmoi në krijimin e një sistemi tregtar shumëpalësh të fortë në zhvillimin i cili u bë gjithmonë e më liberal përmes raundeve të negociatave tregtare. Por gjatë viteve 1980 sistemi kishte nevojë për një drejtim tjetër. Kështu u kalua nga Raundi i Uruguajt në

¹⁷¹ Fondi monetarë ndërkombëtarë www.imf.org

¹⁷² Tregtia ndërkombëtare, Teori dhe Politika (Botimi i dytë) AHMET MANCELLARI

krijimin më 1 Janar 1995 të OBT-së (Organizatës Botërore të Tregtisë). OBT-ja është sot e vetmja organizatë botërore që merret me rregullat e tregtisë midis vendeve. Shumica e vendeve në tranzicion janë tashmë anëtare të OBT-së dhe pothuajse të gjithë kanë aplikuar për t'u anëtaresuar në këtë organizatë. Raundi i Uruguait, duke qenë raundi i fundit i GATT (Marrëveshja e Përgjithshme mbi Tregtinë dhe Tarifat), mund të konsiderohet edhe si raundi i parë i OBT-së, në kuptimin që rezultatet e raundit të Uruguait qelën rrugën dhe shtruan platformën e gjithë veprimtarisë së ardhshme të OBT-së.

Objektivat e OBT-së janë:

- Të ngrejë standartin e jetesës dhe të ardhurat.
- Të sigurojë punësim të plotë.
- Të rrisë prodhimin dhe tregtinë.
- Të lejojë përdorimin optimal të rezervave botërore.

Tre funksionet kryesore të OBT-së janë:

- **Së pari**, të ndihmojë që tregtia midis vendeve të kryhet sa më lirshëm që të jetë e mundur, për sa kohë që ajo nuk shoqërohet me efekte anësore. Para së gjithash, kjo do të thotë zbutje dhe heqjene pengesave tregtare. Por ajo nënkupton edhe njohjen nga ana e individëve, kompanive dhe e qeverive të rregullave të tregtisë dhe dhënien e sigurisë atyre se nuk do ketë asnjë ndryshim të befasishtëm të politikës tregtare, (Mekanizmat e Rishikimit të Politikës Tregtare).
- **Së dyti**, të shërbejë si forum për bisedime lidhur me tregtinë ndërkombëtare (Negociata).
- **Së treti**, përderisa marrëdhënjet tregëtare shpesh nënkuptojnë konflikte interesash dhe përderisa kontratat dhe marrëveshjet, përfshirë ato të vetë sistemit të OBT-së, kërkojnë shpesh interpretim, një funksion i rëndësishëm i OBT-së është të ofrojë procedura neutrale për zgjidhjen e konflikteve midis palëve (Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve).

Për realizimin e funksioneve të mësipërme, vëmendje e veçantë u kushtohet politikave përkatëse, që mund të përmblihen në 5 grupe:

1. Ndihmë për ekonomitë në zhvillim dhe ato në tranzicion.
2. Ndihmë e specializuar për nxitjen e eksporteve (përmes Qendrës Ndërkombëtare të Tregtisë).
3. Marrëveshjet tregtare rajonale.
4. Kooperimi në hartimin e politikave ekonomike globale.
5. Shqyrtimi i politikave tregtare të vendeve anëtare dhe njoftimi i vendeve të tjera anëtare, kur ndonjë prej tyre bënë ndryshime në politikat tregtare.

Parimet kryesore në marrëveshjet e OBT-së dhe në të gjithë veprimtarinë e saj janë:

1. Tregti pa diskriminim

Ky parim ka dy anë: nga njëra anë, sipas këtij parimi një vend normalisht nuk mund të diskriminojë midis partnerëve të tij tregtarë. Ky parim nënkupton që trajtimi i Kombit me të Favorizuar të shtrihet mbi të gjithë partnerët tregtarë. Kjo do të thotë që, sa herë që një vend ulë një pengesë tregtare ose e eliminon atë krejtësisht, ai duhet ta zbatojë atë ndaj të gjithë partnerëve tregtarë. Megjithatë, lejohen disa përjashtime, psh. vendet e rajonit lejohen të arrijnë një marrëveshje tregtie të lirë, që nuk zbatohet ndaj vendeve të tjera (MTL-ja e Shqipërisë me vendet e rajonit). Nga ana tjetër, parimi i mosdiskriminimit nënkupton "trajtimin kombëtarë", pra që vendet nuk mund të diskriminojnë midis produkteve të importuara dhe atyre vendase.

2. Tregti më liberale

Ky parim nënkupton uljen e pengesave tregtare. Objekt i marrëveshjeve për reduktimin e kufizimeve tregtare janë edhe kufizimet jotarifore dhe pengesat e tjera duke u përfshirë edhe fusha të tilla, si tregtia në shërbime dhe në pronën intelektuale.

3. Politika dhe praktika tregtare të qëndrueshme dhe transparente

Ky parim kërkon që vendet anëtare të respektojnë kufijtë maksimal të vendosur prej tarifave ndaj importeve. Në kuadër të këtij parimi, shumë marrëveshje të OBT-së kërkojnë që qeveritë të jenë transparente lidhur me politikat e tyre tregtare si brenda vendit, ashtu edhe për partnerët e tyre tregtare. Qeverive u kërkohet që për qdo ndryshim në politikat dhe praktikat e tyre tregtare të njoftojnë organet përkatëse të OBT-së.

4. Nxitje e konkurrencës

Në të gjithë sistemin e vet, OBT-ja synon në jetësimin e një konkurrence të hapur, të drejtë dhe të padeforuar. Këtij synimi i shërbejnë parimi i Kombit me të Favorizuar dhe ai i Trajtimit Kombëtarë. Këtij synimi i shërbejnë gjithëashtu teresia e marrëveshjeve dhe politikave që trajtojnë dumpingun dhe subvencionet mbi eksportet. Rregullat e vendosura synojnë të përcaktojnë se qfarë konsiderohet konkurrencë e drejtë dhe konkurrencë e padrejtë dhe në

q'menyrë qeveritë mund t'i përgjigjen konkurrencës së padrejtë, duke vendosur tarifa shtesë import për t'u kompensuar nga tregtia e padrejtë.

5. Inkurajimi zhvillimit dhe i reformave ekonomike

Mbi 1/3 e anëtarëve të OBT-së janë vende në zhvillim dhe vende në tranzicion drejt një ekonomie tregu. OBT-ja inkurajon zhvillimin nëpërmjet një trajtimi të veçantë të vendeve në zhvillim. Trajtimi i veçantë nënkupton një qëndrim me fleksibël ndaj vendeve në zhvillim lidhur me detyrimet e tyre për zbatimin e marëveshjeve. Megjithatë, duhet theksuar se hendeuku në trajtimin e vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim ka ardhur duke u ngushtuar.

Politikat tregtare të BE-së

Qështja e politikës tregtare të BE-së është komplekse. Nga njëra anë duhet pranuar se BE-ja vazhdon të ketë një politikë tregtare mbrojtëse. Sic del edhe nga rishikimi i fundit i politikës tregtare të BE-së në kuadër të OBT-së, në periudhën mes dy rishikimeve të politikës tregtare nuk është vërejtur ndonjë përparim i ndjeshëm përse i përket hapjes së tregut evropian. BE-ja po reformon në mënyrë rrënjësore politiken e saj bujqësore. Sipas politikës së re, po kalohet në konceptin e një pagese të vetme "single payment" e cila jepet për mbështetjen e të ardhurave të fermerëve por edhe për mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin rural. Politika e re do të shoqërohet me një reduktim të ndjeshëm të mbështetjes për bujqësinë.¹⁷³

PERFUNDIM

Duke patur parasysh se Organizata Botërore e Tregtisë (OBT) është e vetmja organizatë ndërkombëtare e cila merret me rregullat globale të tregtisë dhe se funksioni i saj kryesor është të sigurojë që tregtia të rrjedhë pa probleme, e pa ndikuar nga politikat ditore të shteteve, ne do të deshironim që kjo organizatë, të beje të pamunduren që tregtia të rrjedhë edhe me lirshëm, për aq sa të jetë e mundur.

Kjo me se miri, përshkruhet tek rregulli I parë në bazë të të cilit funksionon kjo organizatë: tregtia pa diskriminim, e cila rregull, decidivisht thotë se, nëse një shtet anëtar i OBT-së, ulet apo heq ngarkesat doganore në raport me një partner tregtar, të njëjten duhet ta beje dhe në raport me anëtarët e tjerë të Organizatës.

Edhe tek rregulli dy i kësaj organizate, e që njihet si trajtimi kombëtar i barabartë i produkteve të prodhuara në vend dhe i atyre të prodhuara në një vend tjetër për të cilat është paguar taksë, mendoj se OBT-ja nuk ka arritur që të beje identifikimin e sakte të shkeljeve që shtete anëtare të kësaj organizate e bëjnë. Përfundimisht, sipas OBT-së, lehtësimi i tregtisë nënkupton "thjeshtëzimin, standardizimin dhe harmonizimin e procedurave të tregtisë ndërkombëtare", ku me procedura tregtare nënkuptohen aktivitetet, praktikat dhe formalitetet që aplikohen në mbledhjen, prezantimin, komunikimin dhe përpunimin e të dhënave, të cilat janë thelbësore për lëvizjen e mallrave në tregtinë ndërkombëtare"

Duke parë se ka argumente pro dhe kundër kësaj teme të trajtuar në këtë punim, ne dhe në vazhdim të punimeve tjera do të trajtojmë temën e kësaj fushe.

LITERATURA

Tregtia ndërkombëtare, Teori dhe Politika (Botimi i dytë) AHMET MANCELLARI

Banka botërore www.worldbank.org

Fondi monetarë ndërkombëtarë www.imf.org

Guy Pfefferman, "The Eight Losers of Globalization" www.theglobalist.com

¹⁷³ Banka botërore www.worldbank.org